



## **PROCESVERBAL NGA Mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 07**

Datë: 22. 02. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Selmani, drejtoreshë, ud e ZRPP.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 2, 3, 4 dhe 5/2022:**

**3. Aktivitetet e SKQZ:**

**4. Aktivitetet e ZRPPC:**

- Shqyrtimi i Rekomandimit për shqiptim të gjobës për partinë politike Forca e Diasporës për vonesë në dorëzim të formularit të azhurnimeve vjetore.
- Shqyrtimi i Rekomandimit për afat shtesë për mbajtjen e kuvendit zgjedhor të partisë politike “Eko Lëvizja e Gjellbër”,

- Shqyrtimi i Rekomandimit për publikimin e dosjes së Informimit Publik për zgjedhjet e lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021.

## 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Komunat: Dragash, Prizren, Kamenicë dhe Graçanicë.
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së partisë politike “Eko Lëvizja e Gjelbër”.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Dinamik për ndryshim/plotësimin e Rregullave Zgjedhore.

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për realizimin e planit të punës së KQZ-së për vitin 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të KQZ-së për vitin 2022.
- Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Softuerin e Rezultateve.

- **Këshilli për Personel:**

- Shqyrtimi i kërkesës të anëtarit të KQZ-së për angazhimin e një asistenti për kohë të caktuar.

## 6. Të ndryshme.

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**Kreshnik Radoniqi:** E hapim mbledhjen e shtatë të KQZ-së. E keni rendin e ditës, e keni marrë...! Sot mungon anëtari Rifat Krasniq. A ka dikush lidhur me rendin e ditës...?

**Arianit Elshani,** kërkoi tërheqjen nga rendi i ditës të pikës: “Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Softuerin e Rezultateve”. Ai, dha arsyetimin pse, dhe tha se ky dokument të shqyrtohet edhe njëherë në DOZ deri të premtën, dhe të përfshihet cdo detaj në mënyrë që të mos i kemi më në rendin e ditës por të përfundohen këto specitika...

Në vazhdim, miratohet rendi i ditës me nëntë (9)vota për, si dhe procesverbalet procesverbaleve nr. 2, 3, 4 dhe 5/2022, me tetë (8) vota për dhe një votë abstenim (Gordana Llaban).

## **2. Aktivitetet e SKQZ:**

**Burim Ahmetaj**, krye shef i Sekretariatit, e paraqiti një raport mbi aktivitetet e Sekretariatit në ditët e fundit. Ai tha se, procesi i regjistrimit të pasurisë jo financiare për vitin 2021 është kompletuar në fund të muajit janar 2022 dhe tashmë Sekretariati është në fazën e vlerësimit ku ka formuar komision për vlerësimin e pasurisë jo financiare për të vlerësuar vlerën e të gjithë pasurisë jo financiare të KQZ-së dhe statusin e tyre që mund të jenë në përdorim dhe jashtë përdorimit. Për të gjithë pasurinë jo financiare që do të jetë jashtë përdorimit, komisioni do të përgatit raport së bashku me rekomandime për ti adresuar në KQZ për vendim marrje.

Lidhur me procesin e vlerësimit të pasurisë jo financiare, kohën e kompletimit të këtij procesi do të ketë në mesin e muajit mars 2022, kur edhe do të trajtohet raporti fillimisht në Menaxhmentin e Sekretariatit dhe më pastaj në KQZ. Objekt i vlerësimit është gjithë pasuria jo financiare e KQZ-së që ndodhet në Qendër (objektin e KQZ), nëpër zyre të zyrtarëve të lartë komunal të zgjedhjeve dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ku janë të grumbulluara një pjesë e madhe e artikujve të cilët pothuajse janë jashtë përdorimit për shkak të vlerës së vjetërsisë dhe përdorimit.

Gjatë viti 2021, Sekretariati ka prezantuar në KQZ një raport të vlerësimit të pasurisë jo financiare për tjetërsimin e pasurisë, mirëpo për shkak të angazhimit në përgatitje të zgjedhjeve lokale ky proces nuk ka mundur të realizohet sa i përket procedurave të tjetërsimit përmes ankandit apo donacionit.

Ahmeti, raportoi edhe lidhur me kthimet e pagesave të trupave menaxhuese zgjedhore që kanë punuar në zgjedhjet lokale 2021. Ai tha se Sekretariati ka identifikuar një numër të kthimeve (rreth 500 persona) të pagesave të Trupave Menaxhuese Zgjedhore (TMZ) që kanë qenë të angazhuara në zgjedhjet lokale 2021 përfshirë edhe Raundin e dytë, të cilat janë kthyer nga bankat komerciale për shkak të gabimeve teknike, që shumica janë për shkak të xhirologarive gabim dhe ato mjete nuk kanë mundur të realizohen gjatë vitit 2021. Sekretariati ka pranuar kthimet nga Bankat dhe i ka trajtuar të gjitha këto raste për ti kompletuar dokumentacionin dhe për të bërë pagesat e tyre.

Jemi duke identifikuar linjat buxhetore nga të cilat do të merren këto mjete për ti realizuar pagesat e kthimeve nga bankat.

Lidhur me raportin vjetor të punës së KQZ-së për vitin 2021 për raportim në Kuvendin e Kosovës, Ahmetaj the se Sekretariati gjatë muajit janar 2022 ka filluar me draftimin e raportit vjetor të punës së KQZ për vitin

2021, i cili duhet të dorëzohet në Kuvendin e Kosovës më së largu deri me 30 prill 2022. Raporti është në fazën e draftimit dhe të gjitha Departamentet dhe Njësitë janë duke i dërguar raportet që përfshijnë procesin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës që janë mbajtur me 14 shkurt 2021 dhe zgjedhjet lokale që janë mbajtur me 17 tetot 2021. Në fillim të muajit prill planifikohet që drafti i raportit vjetor të punës së KQZ-së për vitin 2021 të jetë i gatshëm për tu shqyrtuar në Sekretariat e më pastaj të trajtohet në KQZ.

Çështja e asgjësimit të materialeve zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale 2021, z. Ahmetaj tha se Sekretariati në bazë të planit të prokurimit, ka filluar procedurat për zhvillimin e aktivitetit të prokurimit për asgjësimin e materialit zgjedhor. Në anën tjetër, Sekretariati ka kërkuar nga PZAP dhe Prokuroria e Shtetit të identifikojnë listen e materialeve nga vendvotimet që duhet të ruhen për shkak se mund të jenë objekt i hetimit për zgjedhjet lokale 2021. Nga prokuroria e Shtetit dhe PZAP kemi pranuar listën e materialeve nga vendvotimet që duhet të ruhen dhe tashmë Sekretariati është edhe në një proces tjetër duke analizuar dhe identifikuar të gjitha vendvotimet që kanë dallime në vota para dhe pas rinumërimit për të përgatitur raportin dhe të prezantojë në KQZ së bashku me rekomandime për ruajtjen e materialeve për shkak të dallimeve në vota para dhe pas rinumërimit.

Pas këtij procesi dhe kompletimit të procedurave të prokurimit, do të mund të fillojë procesi i asgjësimit të materialeve nga zgjedhjet lokale 2021 të cilat nuk janë objekt hetimit.

Po ashtu, Ahmetaj foli edhe mbi ca probleme në në ëeb faqen e KQZ-së të cilat probleme, tani janë rregulluar. Dhe në fund, kujtoi faktin se në kuadër të aktiviteteve të veta, Sekretariati ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), ku pjesë e raportit ka qenë “Monitorimi i deklaratës së mirësjelljes në media sociale gjatë zgjedhjeve lokale 2021”. Prezantimi i këtij raporti është bërë më 15.02.2022 nga ora 10:00 në Hotel Sirius, më 15.02.2022. Gjatë përgatitjes së raportit një pjesë e stafit të Sekretariatit të KQZ-së kanë dhënë kontribut.

### **3. Aktivitetet e ZRPPC:**

1. Shqyrtimi i Rekomandimit për shqiptim të gjobës për partinë politike Forca e Diasporës për vonesë në dorëzim të formularit të azhurnimeve vjetore:

**Valmira Selmani, ud së drejtorit të ZRPP** tha se, zyra e ka shpërndarë raportin e punës, dhe se rekomandimi i parë lidhet me shqiptim të gjobës për partinë politike Forca e Diasporës për vonesë në dorëzim të formularit të azhurnimeve vjetore për shkak të vonesës së dorëzimit të formularëve të azhurnimit vjetorë. Nga 49 subjekte në regjistrin e partive, një nuk e ka respektuar afatin. Kjo, është

subjekti Forca e Diasporës, dhe ne rekomandojmë për shqiptim të gjobës e cila, është në vlerë prej 320 euro.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim për shqiptim të gjobës me 10 vota për...

## 2.Shqyrtimi i Rekomandimit për afat shtesë për mbajtjen e kuvendit zgjedhor të partisë politike “Eko Lëvizja e Gjelbër”:

**Valmira Selmani**: Një subjekt politik “Eko Lëvizja e Gjelbër”, ka kërkuar afat shtesë për mbajtjen e kuvendit zgjedhor. Në bazë të autorizimeve dhe rregullave, ne kemi pranuar kërkesën gjë që ky subjekt e ka arsyetuar mos mbajtjen për shkak të masave covid. Është kërkuar afat deri më 24 maj për mbajtjen e kuvendit. Ne, pas shqyrtimit të kërkesës, rekomandojmë që të miratohet kërkesa e këtij subjekti.

**Kreshnik Radoniqi**: Nëse nuk ka kundërshtim, kush është për ?

Miratohet me 10 vota për, pra aprovohet rekomandimi i zyrës.

## 3.Shqyrtimi i Rekomandimit për publikimin e dosjes së Informimit Publik për zgjedhjet e lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021:

**Valmira Selmani**: Rekomandimi ynë i rashës është për publikimin e dosjes së Informimit Publik për zgjedhjet e lokale në Republikën e Kosovës të datës, 17 tetor 2021. Zyra, duke vepruar përmes KQZ, krijon dhe ruan dosjen e informimit për subjektet politike që përmban regjistrin e donatorëve të subjekteve që marrin pjesë në zgjedhje, raportet e publikimit financiarë, si dhe formularët e publikimit financiarë të kandidatëve.

Ne, për ta publikuar kërkojmë miratimin tuaj, sipas rregullave të zyrës dhe ligjit.

**Alim Rama**, tha se nëse dosja është gati, ajo duhet të publikohet. Ndërsa, Arianit Elshani, tha se ashtu si edhe publikimet e hershme lidhur me zgjedhjet lokale dhe parlamentare që janë publikuar, edhe kjo dosje duhet publikuar sepse, kjo rritë transparencën. Ky publikim, është me rëndësi sepse, shmangë çdo paragjykim lidhur me financimin e partive politike.

Në fund, rekomandimi u miratua në mënyrë unanime me 10 vota.

#### **4. Raport i Këshillave të KQZ-së**

##### **1. Këshilli për Cështje Ligjore:**

##### **Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Komunat: Dragash, Prizren, Kamenicë dhe Graçanicë:**

**Sami Kurteshi**, tha se është mbajtur mbledhja e këshillit ku janë shqyrtuar tri pika. E para, zëvendësimi i anëtarëve të kuvendeve komunale në Dragash, Prizren, Kamenicë dhe Graçanicë. Pas shqyrtimeve, analizave dhe vlerësimeve ligjore. E keni edhe tabelen, ne i kemi miratuar në mënyrë unanime në këshill...

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Prizrenit, i dorëhequri Hanefi Muharremi zëvendësohet nga Haziz Hodaj nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Dragashit, i dorëhequri Fejsal Haliloviqi zëvendësohet nga Edin Kurt nga subjekti politik JGP. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Kamenicës, i dorëhequri Zotrim Kastrati Hanefi Muharremi zëvendësohet nga Labinot Skoverqani nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Kamenicës, Diana Kryeziu zëvendësohet nga Krenare Mavriqi nga subjekti politik AAK. Kush është për...?

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Në komunën e Graçanicës, i dorëhequri Leotrim Ahmeti zëvendësohet nga Granit Gashi nga subjekti politik "Aleanca shqiptare". Kush është për...?

Miratohet...

##### **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Dinamik për ndryshim/plotësimin e Rregullave Zgjedhore:**

**Sami Kurteshi**, tha se e kemi pranuar këtë plan nga zyra Ligjore. Në lidhje me këtë që, do tjetë edhe pjesë e planit të punës së KQZ-së. Ne e kemi miratuar, natyrisht me vlerësime dhe sugjerime të ndryshme dhe të shumta...

Për ta kuptuar anëtarët e KQZ-së dhe të gjithë ne, tha z. Kurteshi, e ftoj përfaqësuesin e zyrës ligjore që të na e shpjegojë në pika të shkurtër këtë plan dinamik...

**Emira Alushi** nga zyra ligjore, tha se është përgatitur draft-planin për ndryshim dhe plotësim të rregullave zgjedhore. Ne, e kemi hartuar planin me njësitë e Sekretariatit dhe, në bashkëpunim me OSBE.

Në vazhdim, përfaqësuesja e zyrës Alushi, shpjegoi bazën, strukturën dhe perspektivën e këtij draft-planin...

**Sami Kurteshi**, tha se në këshill kemi diskutuar gjatë, dhe se janë diskutue metodat, afatet, dhe se si afat kemi kërkuar 15 prillin. Pra, ka kohë që të punohet pa presion në të gjitha format dhe mënyrat...

Lidhur me planin diskutuan: Arianit Elshani i cili e vlerësoi punën e bërë për një plani dinamik. Tani, kemi një plan të mirë, dhe kam disa vërejtje më shumë teknike, sidomos teknike...Por, gjithsesi e vlerësoj këtë punë lidhur me rregullat...

Çemailj Kurtişi, tha se kemi diskutuar mjaft në këshill, kemi shtruar pyetje, kemi dhënë sugjerime dhe mendoj se duhet pasur kujdes që puna të jetë kualitative, dhe në fund të jetë gjithçka mirë e realizuar, pa gabime e lëshime...

Mendoj që, s' duhet bërë presion mirëpo, duhet angazhim dhe të përmirësohen gabimet eventuale dhe, në fund cdo gjë të jetë në rregull...

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Alim Rama, Ilir Gashi,

## **2. Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për realizimin e planit të punës së KQZ-së për vitin 2021:**

**Arianit Elshani**, tha se këshilli ka mbajtur takimin e tij dhe se, e kemi analizuar edhe përgjatë punëtorisë së KQZ-së. Se sa është realizuar, në c 'masë, me sa seriozitet, dhe sa janë arritur objektivat e keni edhe ën formë tabelare...

Mirëpo, ne kishim dy palë zgjedhje në vitin e kaluar dhe ne në këshill, dhe se përkundër kësaj është arritur një masë e mirë e realizimit të planit, mirëpo të tjerat objektiva janë bartur në këtë vit... Ne, veç kemi filluar disa specifika të mbetura që ti zbatojmë, prandaj në përgjithësi, ne rekomandojmë për miratim...

Ky raport, miratohet në mënyrë unanime me 10 vota.

## 2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të KQZ-së për vitin 2022:

Gjithashtu, në takim ne shqyrtoam edhe planin e punës të KQZ-së për vitin 2022 lidhur me aktivitetet që duhet të planifikohen dhe përfshihen në kuadër të planit për këtë vit. Pra, të kemi një plan real, dhe të balancuar që të mund ta realizojmë, dhe të përfshijë edhe sugjerimet dhe rekomandimet tona dhe të organizatave ndërkombëtare. Me një strategji efikase, të realizohet ky plan me specifikat që ka, tha z. Elshani. Gjithsej, janë 57 aktivitete të përfshira në plan. Prandaj, rekomandimi ynë është që plani të miratohet...

**Kreshnik Radoniq:** Kush është për...?

Me 10 vota për, miratohet plani i punës

## **3. Këshilli për Personel:**

Shqyrtimi i kërkesës të anëtarit të KQZ-së për angazhimin e një asistenti për kohë të caktuar:

**Alim Rama:** Duke u mbështetur në udhëzimin administrativ të KQZ për përdorimin e veturave zyrtare për anëtarët e KQZ-së, vajtje – ardhjet, dhe meqenëse asnjë veturë nuk i plotëson kriteret si për kolegun, Këshilli i Personelit i rekomandon angazhimin e një asistent – shofer që, kolegu ti kryej detyrat e tij. Këshilli, rekomandon që ky propozim yni të aprovohet...

Në këtë pikë, diskutoi Ilir Gashi rreth buxhetit që duhet të ketë lidhur me këtë rekomandim, në mënyrë që pastaj të mos ketë problem...

Burim Ahmetaj, tha se deri në qershor kur të rishikohet buxheti, kemi mjete...

Miratohet ky rekomandim me 9 vota për...!

## **Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për Softuerin e Rezultateve.**

Kjo pikë, u la që të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së KQZ.

## **5 Të ndryshme !**

**Arianit Elshani,** pyeti rreth hapësirës së KQZ, ku qëndron gjendja tani...? E po ashtu, z. Elshani pyeti edhe rreth automjeteve të KQZ-së që tha se, veturat aktuale të KQZ nuk janë të sigurta për vozitje...



**Burim Ahmetaj** tha se, kjo çështje është aktuale qe 6-7 vite. Mirëpo, kjo nuk realizohet. Kemi një opsion të marrim vetura për qira, për ato vetura që janë në gjendje më të keqe, mirëpo jo edhe blerjen e tyre... Ndërsa, për objektet-hapësirat, ende nuk kemi diçka konkrete të kënaqshme...megjithëse, kemi komunikuar...si kemi ndërprerë kontaktet..

Për ne, është me rëndësi të hyjë në IPA fleta poseduese jona...

Lidhur me çështjen e veturave, diskutoi edhe Sami Kurteshi, Rifat Krasniqi, Kreshnik Radoniqi dhe Arianit Elshani.